



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E MJEDISIT

Raport individual i konsultimit publik për projektvendimin:

“Për disa ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 162, datë 19.2.2020 “Për rregullat e hollësishme për hartimin, miratimin, rishikimin dhe zbatimin e programeve të pakësimit të shkarkimeve në ajër””.

1. Titulli i projekt aktit

Projektvendim “Për disa ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 162, datë 19.2.2020 “Për rregullat e hollësishme për hartimin, miratimin, rishikimin dhe zbatimin e programeve të pakësimit të shkarkimeve në ajër””.

Qëllimi kryesor i projektvendimit është përditësimi dhe përmirësimi i kuadrit rregullator për hartimin, miratimin, rishikimin dhe zbatimin e Programeve të Pakësimit të Shkarkimeve në Ajër, nëpërmjet rishikimit të disa dispozitave të Aneksit III të Vendimit nr. 162, datë 19.2.2020. Ndryshimet e propozuara synojnë forcimin e kërkesave teknike për hartimin dhe përditësimin e projeksioneve të shkarkimeve në ajër, përmirësimin e cilësisë dhe besueshmërisë së të dhënave të raportuara, si dhe harmonizimin e tyre me metodologjitë dhe standardet ndërkombëtare të raportimit. Në këtë mënyrë, synohet garantimi i një procesi më efektiv dhe të qëndrueshëm për planifikimin, monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve në ajër, në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare.

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Specifikoni kohëzgjatjen e përgjithshme të konsultimeve publike sa i përket ditëve të punës, përfshirë datën e hapjes dhe mbylljes së konsultimeve publike; nëse kohëzgjatja ishte më e shkurtër se 20 ditë pune e paraparë me ligj, jepni arsye për shkurtimin e kohëzgjatjes.

Në zbatim të ligjit nr. 146/2014, “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, projektvendimi “Për disa ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 162,

datë 19.2.2020, “Për rregullat e hollësishme për hartimin, miratimin, rishikimin dhe zbatimin e programeve të pakësimit të shkarkimeve në ajër” iu nënshtrua procesit të konsultimit publik nëpërmjet publikimit në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike (RENJKP).

Konsultimi publik u zhvillua për periudhën nga data 1.4.2026 deri më 29.4.2026, në përputhje me afatin minimal të përcaktuar në ligjin nr. 146/2014.

Gjatë kësaj periudhe, institucionet publike, organizatat e shoqërisë civile, komuniteti i biznesit, ekspertët e fushës, si dhe çdo palë tjetër e interesuar, patën mundësinë të njiheshin me përmbajtjen e projektvendimit dhe dokumentacionin shoqërues, si dhe të paraqisnin komente, sugjerime apo vërejtje në kuadër të procesit të konsultimit publik.

3. Metodat e konsultimit

Listoni të gjitha metodat e konsultimit të përdorura, të tilla si konsultimet elektronike (Regjistri Elektronik, posta elektronike, faqet e internetit, etj.), Takimet publike, seancat e organeve këshilluese..., dhe siguroni informacione për afatin kohor, kohëzgjatjen dhe afatet e tyre.

Shpjegoni se si u shpërnda informacioni mbi konsultimet e hapura, si u ftuan palët e interesuara të kontribuojnë.

Përfshini gjithashtu aktivitete nga konsultimet paraprake nëse janë organizuar të tilla).

Metodat e konsultimit të përdorura për këtë projektvendim, ishin:

1. Publikimi në regjistrin elektronik të njoftimit dhe konsultimit publik (RENJKP);
2. Nëpërmjet postës elektronike.

4. Palët e interesit të përfshira

Listoni të gjithë palët e interesuara, qoftë organizata apo individë, të cilët kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike përmes metodave të ndryshme të konsultimit, gjatë gjithë procesit të hartimit.

Përmendni gjithashtu numrin dhe strukturën e palëve të interesuara që morën pjesë në takime publike ose seanca të organeve këshilluese.

Specifikoni palët e interesuara që morën pjesë në grupin e punës për hartimin e aktit.

Përveç publikimit në Regjistrin Elektronik të Njoftimit dhe Konsultimit Publik (RENJKP), projektakti iu përcoll edhe institucioneve dhe palëve të interesuara nëpërmjet postës elektronike, me qëllim sigurimin e pjesëmarrjes sa më të gjerë në procesin e konsultimit. Gjatë periudhës së konsultimit publik nuk u paraqitën komente apo sugjerime nga palët e interesuara.

5. Pasqyra e komenteve të pranuara me arsyetimin e komenteve të pranuara/ refuzuara

Gruponi komentet/ propozimet e pranuara sipas çështjes që ato ngritën;

Gruponi komente të ngjashme së bashku dhe renditni palët e interesuara që i ngritën ato;

Shpjegoni cili ishte vendimi i marrë dhe sqaroni shkurtimisht arsyet për të.

Numri i shikimeve në RENJKP për këtë projekt ishte 260 dhe procesi i konsultimit nuk është shoqëruar me komente, nga qytetarët, pas publikimit në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike.

Çështja e adresuar	Komenti	Palët e intresuara	Vendimi	Justifikimi
Nuk ka	Nuk janë paraqitur komente.	-	-	Nuk ka komente për t'u shqyrtuar.

Gjatë procesit të konsultimit publik nuk u paraqitën komente apo propozime nga palët e interesuara. Për rrjedhojë, nuk u evidentuan ndryshime në projektakt si rezultat i konsultimit publik.